

VENDIM
Nr. 49, datë 5.12.2016

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMITETIT PËR ZHVILLIMIN E
RAJONEVE NR. 23, DATË 18.4.2016

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15, të aneksit 3, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Në tabelën nr. 1, që i bashkëlidhë vendimit nr. 23, datë 18.4.2016, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, “Për shpërndarjen e financimit për projekte të grantit “Shëndetësia”, thirrja e parë, programi i zhvillimit të infrastrukturës vendore dhe rajonale, shtylla I, për vitin 2016”, bëhet një ndryshim, sipas tabelës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen ministri i Shëndetësisë dhe ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYETARI
Niko Peleshi

Zëvendëskryeministri	Zëvendëskryetar,
Ministri i Financave	anëtar,
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit,	
Tregtisë dhe Sipërmarrjes	anëtar
Ministri i Zhvillimit Urban	anëtar,
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	anëtar,
Ministri i Arsimit dhe Sportit	anëtar,
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe	
Administrimit të Ujërave	anëtar,
Ministri i Shëndetësisë	anëtar,
Ministri i Kulturës	anëtar,
Ministri i Mjedisit	anëtar,
Ministri i Punëve të Brendshme	anëtar,
Ministri i Shtetit për Inovacionin	
dhe Administratën Publike	anëtar,
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	anëtar,
Kryetari i Shoqatës së Qirqeve të Shqipërisë	anëtar,
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë /	
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.1	anëtar,
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore /	
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.2	anëtar,
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.3	anëtar,
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.4	anëtar,

Tabela 1. Lista e projekteve të shëndetësisë me cikël financimi 2016-2017, me shtim financimi për vitin 2016, dhe saktësim të vlerës së mbetur të financimit për vitin 2017, granti “Infrastruktura vendore dhe rajonale”, programi i zhvillimit vendor dhe rajonal, shtylla II.

Tabela 1, e vendimit nr.23, datë 18.4.2016, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, zëvendësohet me tabelën, si më poshtë vijon:

Nr.	Autoriteti kontraktues	Emri i projektit	Vlera e projektit (Lekë)	Vlera e kontratës (Lekë)	Vlera e financimit të miratuar për vitin 2016 (Lekë)	Fonde që i shtohen financimit të vitit 2016 (Lekë)	Vlera e mbetur e financimit për vitin 2017 (Lekë)
QARKU TIRANË							
1	Bashkia Kamëz	Rikonstruksion i QSH në Bashkinë Kamëz	83 873 529	63 322 219	13 185 209	12 981 000	37 156 010
TOTALI			83 873 529	63 322 219	13 185 209	12 981 000	37 156 010

Shënim:

1. “Vlera e kontratës” përfaqëson vlerën e kontraktuar nga autoriteti kontraktues për zbatimin e punimeve të projektit, të miratuar për financim nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve. Vlera e kontratës përcillet nga sekretariati teknik (Ministria e Shëndetësisë).
2. “Fonde që i shtohen financimit për vitin 2016” tregon vlerën e fondit që shtohet, mbi financimin e miratuar deri tani me vendim të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve gjatë vitit 2016, për objektet që kanë ecuri faktike punimesh, më shumë se vlera e financimit të miratuar në vendimet e mëparshme të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, për vitin 2016. Kjo vlerë pakëson vlerën e mbetur për financim në vitin 2017. Vlera që shtohet përcillet nga sekretariati teknik (Ministria e Shëndetësisë), me shkresën nr.2310/5 prot, datë 26.9.2016, dhe shkresën nr.2310/9 prot, datë 25.10.2016.
3. “Vlera e mbetur e financimit për vitin 2017”, tregon vlerën e mbetur të financimit, pas diferencës midis vlerës së kontratës, vlerës së financimit të miratuar në vitin 2016, dhe të shtuar me këtë vendim, sipas realizimit në fund të vitit buxhetor 2016.

